



BASHKIA BERAT

BUXHETI I QYTETARËVE



2018



Të nderuar qytetarë,
ky dokument paraqet në mënyrë të përmbledhur buxhetin
e Bashkisë Berat për vitin 2018 dhe tregon burimet dhe
mënyrat e shpenzimit të fondeve.

Buxheti i këtij viti, ka për qëllim kryesor vazhdimin e
përmirësimit të infrastrukturës rrugore, të shërbimeve
publike, të arsimit, rritjen e hapësirave të gjelbërta, etj.
Duke patur në qendër të vëmendjes interesin publik,
jemi përpjekur të planifikojmë fondet e nevojshme
për të nxitur zhvillimin ekonomik vendor nëpërmjet
investimeve publike.

Kjo iniciativë është pjesë e masave të bashkisë për
rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe lehtësimin e
pjesëmarrjes suaj në vendim-marrje. ””

Petrit Sinaj
Kryetar i Bashkisë


OBJEKTIVAT E BASHKISË BERAT PËR VITIN 2018

Qendër Ndërkombëtare e Turizmit Kulturor, mbështetur në turizmin familjar, që ruan dhe zhvillon trashëgiminë e tij unike kulturore, historike dhe arkitekturore.

Zhvillimi i harmonizuar i një ekonomie konkurruese në tregun rajonal, me biznese kryesisht të agrobiznesit e artizanatit, që zgjerohen e inkurajohen për të pasur diversitetet e cilësi.

Një jetë sociale cilësore, dinamike dhe gjithëpërfshirëse ku shanset individuale për progres dhe mirëqenie mbështeten e zgjerohen në mënyrë të barabartë.

Forcimi i disiplinës fiskale, duke respektuar rregullat dhe parimet e sanksionuara me ligj në hartimin, konsultimin, miratimin, zbatimin, raportimin dhe auditimin e buxhetit vendore, duke synuar një menaxhim të shëndoshë financiar.




Zhvillimi i ekuilibruar i territorit në përputhje me parametrat bashkëkohore mjedisore dhe urbane dhe në harmoni me tiparet specifike të trashëgimisë së qytetit.

Maksimizimi i të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat vendore, duke rritur ndjeshëm ato nëpërmjet shtimit të bazës (nr.) së taksapaguesve dhe jo nëpërmjet rritjes së nivelit të taksimit.


Evidentimin dhe rregjistrimin real të çdo taksapaguesi si dhe zbatimin e procedurave efektive për të thjeshtuar marrëdhëniet e tatimpaguesit me administratën tatimore vendore

Rritjen e cilësisë së shërbimeve në sektorët prioritarë, shërbime publike, arsim dhe infrastrukturë rrugore në gjithë territorin e bashkisë në shërbim të përmirësimit të jetesës së qytetareve


CILAT JANË BURIMET E FINANCIMIT TË BASHKISË?



Taksë vendore - një pagesë e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person që ushtron një të drejtë apo përfiton një shërbim publik në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.



Tarifë vendore - një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.




Fondet e pakushtëzuara janë fonde të dhëna nga qeveria qendrore, për funksionet e bashkisë, pa qëllim të paracaktuar.

Fondet specifike janë fonde të dhëna nga Qeveria qendrore për funksionet e transferuara rishtazi në nivel vendor.

Burimet e tjera të financimit janë të ardhurat e trashëguara nga vitet e mëparshme, të ardhurat nga disa ndërmarrje të bashkisë dhe nga huamarrja.

SI I SHPENZON FONDET BASHKIA?



Bashkia nëpërmjet buxhetit për vitin 2018 do të investojë në:

1. Vendosjen në efikasitet të plotë të Zyrës me një ndalesë (One-Stop Shop);
2. Përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe sportive nëpërmjet rikonstruktimit tërësor ose pjesor të disa kopshteve, shkollave dhe palestrave;
3. Implementimin e sistemit PAV (platforma e administratës vendore) dhe krijimin e Regjistrat Qendror të personelit të administratës vendore;
4. Rritjen e hapësirave të gjelbra nëpërmjet mbjelljes së rrënjëve të reja;
5. Rikonstruksionin e Muzet historik në Sinjë, Qendra Kulturore Margarita Tutulani, shtimin e fondit për Galerinë e Arteve “Eduard Lear”, shtimin e fondeve për bibliotekën “Vexhi Buharaja”, etj.
6. Shtrirjen e sistemit Informatik të Administrimit të Taksave (TAIS) edhe në njësitë administrative Roshnik, Sinjë, Velabisht dhe Otlak.
7. Hartimin e planit sektorial për turizmin, përfshirë identifikimin dhe përcaktimin e itinerareve dhe destinacioneve të reja turistike në qytet dhe zonat kodrinore – malore;
8. Trajtimin e familjeve në nevojë me ndihmë ekonomike, pagesat për personat me aftësi të kufizuara si dhe disa projekte për çeljen e Kampit Veror për fëmijët e komuniteteve Rom, Egjiptian dhe të Margjinalizuara”, projekti për organizimin e aktivitetëve në fund të vitit për fëmijët jetim, etj.



Bashkia do të shpenzojë për ofrimin e shërbimeve publike dhe përmirësimin e infrastrukturës së transportit për qytetarët 36% te totalit të buxhetit të Bashkisë.

Me këto fonde Bashkia do të ofrojë shërbime publike në:

Pastrimi, Gjelbërimi dhe Ndriçimi

- Të kryejë të gjitha proceset teknologjike për gjelbërimin në një sipërfaqe të gjelbër prej 93.203 m²;
- Të mbjellë 320 rrënjë drurë të rinj, 600 shkurre në rrugë e lulishte dhe mbi 200 rrënjë trëndafila. Si dhe të mbjellë me lule sipas sezoneve rreth 4821 m² sipërfaqe;
- Grumbullimin dhe largimin e mbeturinave, pastrimin e rrugëve, etj.

Infrastruktura Publike dhe Transporti Rrugor

- Mirëmbajtje në të gjitha sheshet e qytetit dhe njërive vendore;
- Mirëmbajtje rreth 80 942 m² rrugë si dhe shtimin e 3 500 m² rrugë të reja, përfshirë ndriçim rrugor.
- Mirëmbajtje në të gjitha rrugët rurale të asfaltuara.
- Mirëmbajtje në kanalizimet e ujërave të bardha në Njësitë Administrative Velabisht, Sinjë, Otlak dhe Roshnik;
- Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore në gjithë territorin e bashkisë.

PROGRAMI I KUJDESIT SOCIAL

Bashkia planifikon të shpenzojë rreth 24.3 milion lekë për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara në Qendrën “Lira” përgajtë vitit 2018.

Bashkia Berat do të trajtojë familjet në nevojë me ndihmë ekonomike, pagesa të paaftësisë për personat me aftësi të kufizuara si dhe do të organizojë disa projekte si projekti për çeljen e Kampit Veror për fëmijët e komiteteve Rom, Egjiptian dhe të Mazhorancës”, projekti për organizimin e aktivteteve në fund të vitit për fëmijët jetimë, etj.

ARSIMI DHE EDUKIMI



Bashkia planifikon të shpenzojë 258 milion lekë ose rreth 23% të buxhetit të përgjithshëm për arsimin parauniversitar dhe edukimin.

Bashkia gjatë vitit 2018 synon të realizojë mirëmbajtjen e kopshteve, çerdheve dhe shkollave të qytetit.

Do të rikonstruktohen plotësisht shkollat 9-vjeçare “1 Maji”, “Uznovë”, “Starovë”, dhe “Dushnik”; çerdhet “Uznovë” dhe ajo “Nr.7” si dhe Kopështi “Donika Kastrioti”.

Do të realizohet rikonstruktion i pjesshëm në konviktin e shkollës së mesme bujqësore “Kristo Isak”, në amfiteatrin e shkollës së muzikës Ajet Xhindole, në shkollën Mangalem, Kristaq-Capo, Pafal, Veterik, Zihni Toska, Roshnik, Bogdan, Karkanjoz.

Do të ndërtohet një kopësht i ri në Dushnik dhe si dhe fushë sportive në shkollën Moravë si dhe do të krijohet ambjent për një kopësht të ri në shkollën Drobonik.



KULTURA DHE SPORTI



Bashkia planifikon të shpenzojë 95.5 milion lekë për mbështetjen e aktiviteteve për kulturën dhe sportin. Objektivat e Bashkisë përfshijnë:

Kultura

- Rikonstruktion i Muzet historik në Sinjë. (investim i nisur ne vitin 2017), Qendra Kulturore Margarita Tutulani;
- Shtimin e fondit për Galerinë e Arteve “Eduard Lear”, për bibliotekën “Vexhi Buharaja”, etj.;
- Ngritjen e një grupi për bashkëmenaxhimin e Qendrës Historike në bashkëpunim me qytetarët;
- Organizimin e aktiviteteve promovuese për kulturën dhe turizmin, si Ditët e Turizmit në Berat, përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve informuese për paketën turistike, etj.;
- Projektin Trashëgimia Botërore në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS) dhe Monitorimi Fotografik i Trashëgimisë Kulturore.

Sporti

- Mbështetjen e Klubit të Futbollit “FK Tomorri 1923” dhe Klubit Shumë-Sportës “Tomorri”.
- Riparimin e 5 palestrave të shumë-sporteve, si dhe promovimin e aktiviteteve “Vrapo për jetën” dhe “Sporti për të gjithë”.

MJEDISI, BUJQËSIA, PYJET E UJËRAT

Bashkia planifikon të shpenzojë 56.3 milion lekë apo 5.6% të buxhetit të vitit 2018 për mirëmbajtjen e kanaleve kulluese, kanaleve të dyta dhe të treta, për sistemimin e ujitjes dhe të kullimit si dhe për parandalimin e erozionit dhe ndotjes.

Objektivat e Bashkisë për këto para të shpenzuara janë:

Pastrimi i kanaleve ujitës dhe kullues të Starovës, Lapardhas, Moravës, Uznovës, Otlakës, etj.

Për bujqësinë, Bashkia synon të realizojë disa projekte gjatë vitit 2018 si:

- Rehabilitimi i stacionit të elektropompave;
- Rehabilitimi i gjithë rrjetit ujitës, dega kryesore dhe rrjeti kanaleve të dyta;
- Mbrojtja nga gërryerjet e Lumit Osum;
- Inventarizimi i infrastrukturës ekzistuese;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese;
- Mbrojtja nga përmytjet në zonë;
- Rehabilitimi i argjinaturës mbrojtëse.

INVESTIME

Rikonstrukcion rrugesh, trotuar dhe ndricim 30 vjetori Ish Pjeshkorja	36 milion lekë
Rikostrukcion i rrugëve të brendshme dhe Kanalizim i Ujërave të zeza në Fshatin Moravë	8 milion lekë
Asfaltim i segmenteve të rrugës "Antipatrea"	9 milion lekë
Rikostrukcion i rrugës Stadiumi i vjetër, Stadiumi i ri	20 milion lekë
Fasada në hyrje të qytetit të Beratit	5 milion lekë
Blerje fadrome për ndërmarrjen e shërbimeve publike	9 milion lekë
Fasada në lagjen Celebiu	3 milion lekë
Asfaltim dhe shtrim rrugësh me beton, mirëmbajtje me çakull dhe tombino e mure mbajtës në njësitë administrative dhe lagjet e qytetit	30 milion lekë
Ndërtim Ujësjellësi fshati Qereshnik	10 milion lekë
Mirëmbajtje ujësjellëse e Kanalizime të ujërave të zeza	5 milion lekë
Rikonstrukcion i fasadave të ndërtesave dhe stadiumit Tomori	44 milion lekë
Rikonstrukcion i shkollës Starovë	26 milion lekë

PLANIFIKIMI I TERRITORIT, INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE

Bashkia planifikon të shpenzojë rreth 151 milion lekë apo 15% të buxhetit të vitit 2018 për të arrijur disa objektiva lidhur me planifikimin e territorit, investimeve dhe kontrollit të projekteve:

- Mbështetje me infrastrukturën e nevojshme për krijimin e dy qendrave ekonomike rajonale, pranë njësisë Otlak dhe Velabisht;
- Intensifikimi i aktivitetit urbanizues brenda qendrave ekzsituase urbane të njësive administrative duke përfshirë këtu rikonstruksionin e hapësirave urbane në lagjen “Murat Çelebiu”;
- Hartimi i planit sektorial për turizmin, përfshirë identifikimin dhe përcaktimin e intinerareve dhe destinacioneve të reja turistike në qytet dhe zonat kodrinore – malore;
- Modernizimi i shërbimeve publike të ofruara për banorët dhe turistët në zonat e mbrojtura historike (Mangalem dhe Goricë) me fokus infrastrukturor dhe arkitektonik;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimit tregetar, hotelier dhe informativ për turistët në qytetin e Beratit si dhe përgjatë rrugëve panoramike;
- Mbështetja me infrastrukturat dhe shërbimet e nevojshme për zhvillimin e ekoturizmit në njësinë e Roshnikut;
- Mbrojtja e sistemit urban nga përmbytjet e Lumit Osum përmes ndërhyrjeve të integruara në të gjithë koridorin lumor;
- Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave;
- Menaxhimi i mbetjeve të ngurta, ndërtimi i një Landfilli;
- Ndërtimi i Bypass-it të Bashkisë Berat i cili do të ndihmojë në uljen e trafikut ndërqytetas;
- Rikonstruksion i segmentit rrugor Shish-Ura e Re – Shkolla Industriale,
- Rikonstruksion i Bulevardit “Republika”;
- Rikonstruksion i Rrugës “Santa Lucie Filipine”;
- Rikonstruksion i segmentit rrugor që nis nga stadiumi i vjetër – stadiumi “Tomorr” dhe sheshit përpara stadiumit,
- Rikonstruksion i rrugës “Muzak Topia”;
- Hartimi dhe zbatimi i një plani sektorial të transportit publik të integruar;
- Rikonstruksion i Rrugës “Gaqi Gjika”;
- Përmirësimi i infrastrukturës së qendrave shëndetësore në Njësitë Administrative Otlak, Sinjë, Roshnik dhe Velabisht.

FAZAT E BUXHETIMIT



Për hartimin e Buxhetit 2018 u realizuan 9 dëgjesa publike në të katër njësité administrative dhe lagjet e qytetit me grupet e interesit, me shoqërinë civile dhe me komisionin qytetar.

Problematikat e dala nga këto dëgjesa kishin të bënin kryesisht me infrastrukturën rrugore, rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza, përmirësimin e ndiçimit, shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta, përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm.

KALENDARI I PROCESIT TË MENAXHIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PUBLIKE

Subjekti	Afati
Kryetari i bashkisë paraqet për shqyrtim dhe miratim në Këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave	Brenda muajit Janar
Këshilli i bashkisë miraton raportin e vlerësimit dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave	Brenda muajit Shkurt
Këshilli i bashkisë miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm	Deri në 15 Mars
Kryetari i bashkisë nxjerr udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të bashkisë dhe e shpërndan për të gjitha njësitë shpenzuese	5 ditë nga miratimi i taveve përgatitore
Kryetari i bashkisë i dërgon Ministrisë së Financave projekt-dokumentin e programit buxhetor afatmesëm	Deri në 1 Qershor
Ministria e Financave, analizon dhe përgatit një raport me rekomandime mbi projekt-dokumentin e programit buxhetor afatmesëm për çdo njësi dhe ja dërgon zyrtarisht	Deri në 20 Qershor
Këshilli i bashkisë shqyrton dhe miraton projektin e parë të PBA, duke shprehur dhe opinionet mbi rekomantimet e MoF	Deri në 30 Qershor
Kryetari i bashkisë merr masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të PBA të miratuar	Deri në 5 Korrik
Këshilli i bashkisë miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA	Deri në 20 Korrik
Kryetari i bashkisë nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë dhe e shpërndan për njësitë shpenzuese	5 ditë nga miratimi i taveve
Njësia e vetqëqeverisjes Vendore dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e PBA të rishikuar të miratuar nga Këshilli	Deri në 15 Shtator
Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me bashkinë	Deri në 5 tetor
Ministria e Financave dërgon rekomandime përfundimtare për tu reflektuar në dokumentin final të PBA	Deri në 20 tetor
Kryetari i bashkisë përgatit projektin e PBA përfundimtar dhe e paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshillin e NJQV sëbashku me projektbuxhetin vjetor	Brenda muajit Nëntor
Projekti i PBA përfundimtar miratohet nga Këshilli i bashkisë	Deri në 25 Dhjetor
Kryetari i bashkisë merr masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të plotë të PBA të miratuar përfshirë dokumentacionin shoqërues	Deri në 31 Dhjetor
Kryetari i bashkisë paraqet për miratim në këshill projektbuxhetin vjetor	Brenda muajit Nëntor
Këshilli i bashkisë miraton projektbuxhetin	Deri në 25 Dhjetor
Në rast të mosmiratimit të buxhetit kryetari i bashkisë fillon procedurat e buxhetit të përkohëshme	Deri në 1 janar
Kryetari i njësisë së vetqëqeverisjes vendore merr mesa për të publikuar buxhetin vjetor përfshirë dokumentacionin shoqërues në Buletinin e Njoftimeve Publike	Brenda 15 ditëve nga miratimi në këshill
Një kopje e buxhetit vjetor dërgohet në Ministrinë e Financave	Deri në 10 Janar
Pas miratimit nga këshilli, nënpunësi autorizues i bashkisë detajon fondet buxhetore për të gjitha njësitë shpenzuese	Brenda 5 ditëve pas miratimit nga këshilli
Kryetari i bashkisë kryen një analizë të zbatimit të buxhetit dhe nëse është e nevojshme propozon ndryshime	Brenda muajit Qershor
Kryetari i bashkisë paraqet në këshillin përkatës raportin e zbatimit të buxhetit	Çdo 4 muaj



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

Kjo broshurë u bë e mundur me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. Ajo u përgatit nga Projekti i USAID-it për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore.